Në bazë të nenit 52, paragrafi 2, alineja 1 dhe 5, nenit 90, paragrafi 1, alineja 3 e Ligjit për arsim sipëror ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 82/2018) dhe nenit 34, paragrafët, 1, 2, 3 dhe 4 të Statutit të Konferencës interuniversitare nr. 19-1010/2 nga 6.11.2018, Drejtoria rektorale interuniversitare në Republikën e Maqedonisë së Veriut publikon

**THIRRJE PUBLIKE TË PËRSËRITUR nr. 5/2021**

Për zgjedhje të anëtarit të Konferencës interunveritare të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në **Bordit për evaluim të arsimit sipëror, 1 (një) person nga radhët e studentëve.**

*Kushtet për zgjedhje janë:*
- Të jetë student i rregullt në Universitetin Evropian në Shkup.

Kandidatët të parashtrojnë:
- Fletëparaqitje për shpallje;
- Biografi të shkurtë (CV)
- Formular të plotësuar për të dhënat (të mundshme në ueb faqen e UKIM http://www.ukim.edu.mk/ në linkun "tjetër").

Zgjedhja e kandidatëve bëhet në seancën e Konferencës interuniversitare të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në pajtim me Ligjin për arsim sipëror dhe Statutin e Konferencës interuniversitare.

Thirrja publike zgjatë 5 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit.

Dokumentet parashtrohen: përmes postës, në arkivin e Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup, bul. "Goce Dellçev" nr. 9, 1000 Shkup ose përmes formës elektronike.

**Drejtoria rektorate interuniversitare e Republikës së Maqedonisë së Veriut**

---

Në bazë të nenit 7 dhe nenit 8 të Ligjit për themelim të Rrjetit akademik maqedonas për hulumtime ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 124/2010; 47/2011; 41/2014 dhe 11/2018) dhe nenit 34 të Statutit Konferencës interuniversitare nr. 19-1010/2 nga 6.11.2018, Drejtoria rektorale interuniversitare në Republikën e Maqedonisë së Veriut publikon

**THIRRJE PUBLIKE nr. 7/2021**

**Neni 1**

Për zgjedhje të propozim kandidatëve për anëtarë të Këshillit drejtues të Rrjetit akademik maqedonas për hulumtime (MARnet):
- 5 (pesë) persona, prej të cilëve nga një prej secilit universitet shtetëror në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Kriteret për zgjedhje:
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- Të ketë të mbaruar arsimin sipëror, dhe
- Të njeh gjuhën angleze.

Kandidatët parashtrojnë:
- Fletëparaqitje për thirrjen
- Biografi të shkurtë (CV).

Zgjedhja e kandidatëve bëhet në seancën e Konferencës interuniversitare të republikës së Maqedonisë së Veriut, me propozim të Drejtorisë rektorale interuniversitare.

Thirrja publike zgjatë 5 ditë nga dita e publikimit.

Dokumentet parashtrohen:
- përmes postës ose në arkivin e Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup, bul. "Goce Dellçev" nr. 9, 1000 Shkup.

**Drejtoria rektorale interuniversitare**

---

Në bazë të nenit 16, paragrafi 9, alineja 8 dhe nenit 18, paragrafi 1 e Ligjit për Kornizën nacionale të kualifikimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 137/2013 dhe 30/2016) dhe nenit 34 të Statutit të Konferencës interuniversitare nr. 19-1010/2 nga 6.11.2018, Drejtoria rektorale interuniversitare në Republikën e Maqedonisë së Veriut publikon

**THIRRJE PUBLIKE nr. 6/2021**

**Neni 1**

Për zgjedhje të anëtarëve të Konferencës interuniversitare të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në Bordin nacional për Kornizën maqedonase për kualifikime në:
- Komisioni sektorial për **gjeologji, xehetari dhe metalurgji, 1 (një) anëtar;**
- Komisioni sektorial për **art, 1 (një) anëtar;**
- Komisioni sektorial për **elektroteknikë, 1 (një) anëtar;**
- Komisioni sektorial për **shërbime personale, 1 (një) anëtar**
- Komisioni sektorial për **kimi dhe teknologji, 1 (një) anëtar;**
- Komisioni sektorial për **ndërtimtari dhe gjeodezi, 1 (një) anëtar;**
- Komisioni sektorial për **tekstil, lëkurë dhe prodhime të ngjashme, 1 (një) anëtar;**
- Komisioni sektorial për **hoteleri dhe turizëm, 1 (një) anëtar.**

Kriteret për zgjedhje:
- Arsim sipëror të mbaruar në **sferën e sektorit përkatës**
- Aftësi kompjuterike (MS Office)
- Njohje të gjuhës angleze (së paku niveli B1)
- Së paku 5 vjet përvojë pune në **sektorin përkatës**
- Njohje të profesionit në **sektorin përkatës**
- Përvojë të veçantë profesionale: pjesëmarrje në organe, trupa dhe komisione të ndryshme nga sfera e **sektorit përkatës**.

Kandidatët parashtrojnë:
- Fletëparaqitje për thirrjen
- Biografi të shkurtë (CV)
- Deklaratë për konflikt të interesave.

Zgjedhja e kandidatëve bëhet në seancën e Konferencës interuniversitare të Republikës së Maqedonisë së Veriut me propozim të Drejtorisë rektorale interuniversitare.

Thirrja publike zgjatë 5 ditë nga dita e publikimit.

Dokumentet parashtrohen:
- përmes postës ose në arkivin e Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup, bul. "Goce Dellçev" nr. 9, 1000 Shkup.

**Drejtoria rektorale interuniversitare e Republikës së Maqedonisë së Veriut**

---

Duke vepruar sipas nenit 1, paragrafi (2) të Ligjit të Letrave me Vlerë ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 95/2005, 25/2007, 7/2008, 57/2010 135/2011, 13/2013, 188/2013, 43/2014, 15/2015, 154/2015, 192/2015, 23/2016, 83/2018 dhe 31/2020), nenit 84 të Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 124/2015), Komisioni i Letrave me Vlerë i RMV-së e jep këtë:

**KUMTESË**

Komisioni i Letrave me Vlerë i RMV-së dorëzon me shpallje publike aktet që nuk arriti t'i dorëzojë, siç vijon:

1. Aktvendimi nr. PA 12-86, datë 4.10.2021, drejtuar ***Shoqërisë "AGD Ilinden", Shkup,*** me seli në rr. "Skupi" nr. 20 Shkup;
2. Aktvendimi nr. PA 12-89, datë 4.10.2021, drejtuar ***Shoqërisë "Kombiteks" SHA Prilep,*** me seli: rr. "Lece Koteski" nr. 50 Prilep;
3. Aktvendimi nr. PA 12-88, datë 4.10.2021, drejtuar ***Shoqërisë "Karnomak" SHA f. Porodin, Bistricë,*** me seli: f. Porodin, Manastir;
4. Aktvendimi nr. PA 12-93, datë 4.10.2021, drejtuar ***Shoqërisë "Makedonska kniga" SHA Shkup,*** me seli: rr. "E Ankarasë" nr. 33, Shkup;
5. Aktvendimi nr. PA 12-44, datë 20.9.2021, drejtuar ***Shoqërisë "Atom" SHA Shkup,*** me seli: rr. "Gavrill Konstantinoviq" nr.27a Shkup;

U bëhet thirrje personave të lartpërmendur që brenda 10 (dhjetë) ditësh nga publikimi i kësaj kumtese, të paraqiten në hapësirat e Komisionit të Letrave me Vlerë dhe t'i marrin aktet e lartpërmendura.

VËREJTJE: Palët paralajmërohen se mënyra e këtillë e dorëzimit konsiderohet si dorëzim i rregullt, ndërsa çdo pasojë negative e ngjarë, e cila mund të krijohet, do të bartet nga vetë pala.

**Numër 12-720/1**
**11.11.2021**
**Shkup,**

**Komisioni i Letrave me Vlerë i Republikës së Maqedonisë së Veriut**
**Kryetarja**
**Mr.Sc. Nora Aliti**